

## LIGJËRIMI PUBLIK MBI DEKRIMINALIZIMIN DHE INTEGRITETIN, POLITIKËN E PASTËR DHE LLOGARIDHËNIEN<sup>1</sup>

Raporti i Monitorimit të periudhave Tetor-Janar 2022-2023

Procesi i fuqizimit të transparencës dhe llogaridhënies përbën elementet bazë të një qeverie të përgjegjshme. Prej kohësh Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë bërë pjesë e procesit të ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë shqiptare. Përmendim këtu procesin e Vettingut dhe ngritjen e Gjykatës së Posaçme Anti-Korrupsion, SPAK. Me ekspertët e tyre dhe financimet e shumta, faktori ndërkombëtar ka qenë prezent në largimin e disa figurave të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë. Por duket se i njëjti fenomen nuk po ndodh në skenën e partive politike shqiptare. Largimi i figurave politike të lidhura me krimin e organizuar mbetet një sfidë e fortë për shtetin shqiptar dhe faktorin ndërkombëtar.

Për disa figura politike në vend, në nivel lokal, institucionet kompetente shqiptare, si KQZ, kanë hezitur largimin nga politika të personave të inkriminuar.

I miratuar në vitin 2015, ligji i dekriminalizimit erdhi si nevojë e pastrimit të politikës shqiptare nga personat me rekorde kriminale, por shtatë vjet më pas, shumica e ekspertëve e shohin me dyshim suksesin e tij në vetëpastrimin e partive politike – çka synohej të ishte edhe qëllimi kryesor afatgjatë i këtij ligji.

Stafi i Instituti i Studimeve Politike (ISP) kreu monitorimin e ligjërit politik të reflektuar në raportimet e medias gjatë periudhës Tetor -Janar 2022, si pjesë e projektit “Promovimi i transparencës dhe llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur” mbështetur nga NED (National Endowment for Democracy). Monitorimi u shtri në të gjitha mediat kryesore televizive (TCH, Klan TV, Vizion Plus, News 24, Ora News, A2, Abcnews, etj), kryesisht në qëndrimet editoriale dhe në lajmet kryesore të ditës. Gjithashtu u monitoruan portalet kryesore, si dhe mediat e shkruara Panorama, Gazeta Shqiptare, Shekulli dhe Dita

---

<sup>1</sup> Raporti monitorues është shkruar në kuadër të të projektit “Promovimi i llogaridhënies së zyrtarëve të zgjedhur”, i mbështetur nga [National Endowment for Democracy](#) dhe realizuar nga Instituti i Studimeve Politike (ISP)

## Gjetjet kryesore të raportit monitorues (II, 2022)-Raporti përmbledhës

- Periudha e marrë në shqyrtim ka në qendër të vëmendjes debatet për ligjin për dekriminalizimin dhe propozimin e Partisë Socialiste për ndryshimin e një pjesë të këtij ligji. Po ashtu pjesë aktive për të marrë nën hetim zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë politikë, ka qenë SPAK, ku afëra e inceneratorëve dhe ngjarjet e 21 Janarit kanë rikthyer në skenë personazhet të cilët kishin filluar të tërhiqeshin nga jeta politike aktive. Rreth 7 vite pas miratimit të ligjit të dekriminalizimit, inkriminimi i politikës vazhdon të mbetet një fenomen që kërcënon demokracinë në Shqipëri, ndërkohë që partitë politike refuzuan të vetëpastrohen në kundërshtim me frymën e ligjit.
- Muaji Tetor pati në qendër të vëmendjes KQZ. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk i hoqi dot mandatin e Kryebashkiakut të Mallakastrës, Qerim Ismailaj. Në formularin e dekriminalizimit Ismailaj nuk kishte treguar se ishte dënuar me tre vite burgim në Greqi me akuzën e rrahjes, ndërkohë që ai ishte vënë në dijeni nga autoritetet greke për këtë vendim. Më herët edhe prokuroria e përgjithshme sektori i dekriminalizimit kishte vërtetuar dënimin penal në Greqi. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u vu në dijeni por në fund vendosi që të mos ia hiqte mandatin e kryebashkiakut me argumentin se vepra penale që ai kishte kryer në Greqi, në Shqipëri dënohet vetëm me gjobë. Ndërsa në lidhje me këtë çështje, SPAK vendosi të marrë të pandehur Z. Ismailaj me akuzën e fshehjes së dënimit që kryebashkiaku i Mallakastrës kishte marrë në Greqi.
- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në fillim të Janarit 2023 nisi verifikimin e figurës së dy kandidatëve për deputetë në zgjedhjet e prillit 2021; Agron Kapllanaj nga Partia Demokratike dhe Kleo Murataj nga Partia Social Demokratike. Sipas ligjit “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, u ndalohej drejta për t’u zgjedhur në funksionet publike të deputetit, kryetarit të bashkisë ose anëtarit të këshillit bashkiak personave me precedentë të mëparshëm penalë. Verifikimi i thelluar i kryer nga Prokuroria ka nxjerrë në dritë dënime të hershme për të dy kandidatët. I njëjti fenomen ka ndodhur edhe me Kryetarin e Bashkisë së Tepelenës, T.P. Në 2017 Prokuroria do të kërkonte t’i hiqej mandati për falsifikim të formularit kryebashkiakut të Tepelenës. Por kjo kërkesë u rrëzua, ndërsa P. vazhdon të jetë kryebashkiak dhe ende në politikë. Të njëjtin vendim KQZ e pati edhe për A.Z, qytetarin e parë të Poliçanit, duke refuzuar kërkesën e prokurorisë për t’ia hequr mandatin.
- KQZ theksoi para disa kohësh në Parlament problematikën me listat e këshilltarëve bashkiake, ku dhjetëra kandidatë kanë dalë me rekorde kriminale, kanë refuzuar të plotësojnë formularin e dekriminalizimit ose janë dorëhequr, gjë që ka bërë që

procesi i zëvendësimit të tyre të çojë në shterim të listave shumëemërore në disa bashki.

- Arrestimi i Ish-kryebashkiaku i Lezhës, F. F. përbën një nga rastet ku zyrtarë të lartë janë përfshirë në afera korruptive dhe shpërdorim detyre. F.F, u dënua me vendim të formës së prerë me 3 vite burg për shpërdorim të detyrës dhe tjetërsim të pronave tek “Rana e Hedhun” në Shëngjin. Fran Frrokaj është hetuar në gjendje të lirë, dhe në shtator të vitit 2020, Shkalla e Parë e dënoi me 4 vite burg, por Apeli i Shkodrës, vendosi t’ia ulë dënimin në 3 vite.
- Krimi dhe korrupsioni kanë një lidhje me zyrtarët në nivel lokal dhe qendror. Dështimi i largimit të tyre nga pozicionet drejtuese nxjerr në pah brishtësinë dhe fragmentimin e sistemit të drejtësisë. Në fund të muajit Nëntor, V.Ç, drejtor në OST të Fierit, u arrestua nga policia e Shtetit me urdhër të SPAK pas hetimeve për trafik kokaine nga Kolumbia, në kuadër të një grupi të strukturuar kriminal. Ç. i cili mbante postin e drejtorit të administratës në OST, më herët ka qenë kryetar i Komunës së Frakullit në Fier. Faktin e dështimit të largimit të këtyre individëve nga pozicionet drejtuese e vuri në dukje pak kohë më parë edhe institucioni i KQZ në një raportim para Kuvendit të Shqipërisë.
- Po ashtu edhe subjekte të ndryshme zgjedhore janë vënë nën hetim nga organet e drejtësisë. Përmendim këtu Kryetarin e Partisë Lëvizja e Re, i cili është akuzuar për përfitim të paligjshëm të fondeve, kryesisht të emigrantëve shqiptar, por nga dita e djeshme ai ka shpallur kandidaturën për të qenë Kryetar i Bashkisë së Tiranës. Denoncimet e shumta që janë bërë në media nuk kanë mjaftuar për KQZ-në që të nisë verifikimet dhe të dalë me një konkluzion të qartë për të.
- 'Loja' midis institucioneve publike dhe afrimi i fushatës elektorale për zgjedhjet e 14 Majit, ka bërë që procesi i dekriminalizimit të lihet mënjanë ose të devijojë qëllimin e tij primar. Tashmë partia qeverisëse nuk po insiston në largimin emergjent të figurave të inkrinuara por në një qasje tjetër, atë të largimit të personave të cilët mund të kenë pasur lidhje me ish-Sigurimin e Shtetit.
- Disa ekspertë në vend, theksojnë se përveç KQZ-së, është Prokuroria ajo që nuk po bën sa duhet në këtë drejtim, duke krijuar një vakuum të thellë për këtë proces. Por fakt është interesi primar i Partisë Socialiste për të fituar e vetme zgjedhjet e 14 Majit dhe të mos i japë shans partive opozitare të bashkohen mes tyre.
- Partitë politike gjatë periudhës Tetor-Janar vijuan ma akuza dhe kundër-akuza për zyrtarët e përfshirë në akte korruptive dhe pjesë të organizatave kriminale. Partia Socialiste mori në shqyrtim nismën për ndryshimin e disa pikave të ligjit të

dekriminalizimit. Pjesë e këtyre ndryshimeve nuk prekte aspak inkriminimin e zyrtarëve të lartë aktual, por vetëm personat të cilët mund të kenë bashkëpunuar më ish-Sigurimin e Shtetit. Kjo tregon se angazhimi për eliminimin e personazheve problematik nga partitë politike mbetet nul. Partia Socialiste inicioi dy nisma: Asnjë individ me lidhje të dikurshme me ish-Sigurimin e Shtetit nuk mund të ketë funksione publike dhe tjetra, përmend faktin se persona të tillë nuk mund të jenë kryetar të partive politike.

- Daljet publike të figurave kryesore politike ne periudhën e marrë në shqyrtim kanë qenë më të pakta. Atakimi dhe akuzat e ndërsjella mes tyre tashmë gjejnë vend nëpër rrjetet sociale. Periudha e marrë në shqyrtim tregon një devijim të disa personazheve të caktuar të cilët i shmangen daljeve në media dhe mjaftohen vetëm me deklarata në rrjetet sociale. Vihet re një ndarje e thellë mediatike për sa i përket procesit të dekriminalizimit dhe pastërtisë së një figure politike.
- Rasti i prishjes së një biznesi të një pronari mediatik në vend, tregon se media është e pafuqishme përballë presionit të politikës. Faji është vërejtur tek të dyja palët. Qeveria, pasi goditi një biznes të ligjshëm dhe nuk bëri paralajmërim, ndërsa media sepse nuk respektoi hapësirën dhe frekuencën publike, pasi e bllokoi televizionin dhe shtypin e saj të shkruar vetëm për qëllime personale.
- Një element i dallueshëm dhe jo etik është keqpërdorimi që media i bën procesit të dekriminalizimit në vend. Këtu përfshihen zyrtarë politikë dhe figura të drejtësisë. Ndasi të mes palëve politike janë vënë re edhe në media. Kjo tregon presionin dhe eliminimin me çdo kusht të kritikave në vend.
- Sipas Reporterëve pa Kufij, gazetarët në Shqipëri janë në shënjestër të grupeve të kimit të organizuar dhe madje edhe të dhunës policore dhe se shteti nuk po arrin t'i mbrojë ata. Mediat private shpesh janë në pronësi të biznesmenëve që kanë lidhje me politikanë.
- Raporti i fundit i Komisionit Evropian për progresin e Shqipërisë drejt anëtarësimit në BE paralajmëroi se “kryqëzimi i interesave të biznesit dhe politikës vazhdoi të pengonte pavarësinë e medias dhe cilësinë e gazetarisë”. “Dezinformimi duke përfshirë fushatat e shpifjeve janë të përsëritura, veçanërisht në mediat online, vetërregullimi i të cilave duhet të sigurohet”, shkroi Komisioni. “Atmosfera e sulmeve verbale, fushatave shpifëse dhe akteve të kanosjes ndaj gazetarëve nuk është përmirësuar”.
- Në periudhën e marrë në shqyrtim dolën fakte konkrete se janë vetë partitë politike të cilat e shkelin ligjin me vetëdije të plotë. Komisioni i Ankimeve dhe

Sanksioneve, KAS, pranoi kërkesën e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje të sanksioneve administrative ndaj partive politike për raportimin financiar gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare të 25 prillit 2021. Sipas vendimit të KAS, subjektet zgjedhore dhe kandidatët kanë bërë shkelje në deklarimin financiar, duke deklaruar shpenzime, për të cilat në një masë të caktuar nuk disponojnë dokumentacionin justifikues. KAS e gjobiti Partinë Socialiste në pushtet me 5 milionë lekë për tejkalimin e kufirit maksimal të shpenzimeve si dhe me 500 mijë lekë për mungesa në raportimin financiar të kandidatëve.

- I njëjti vendim preku edhe partitë e tjera opozitare. Më konkretisht, Partia Demokratike dhe 7 subjekte të tjera zgjedhore – Lëvizja për Zhvillim Kombëtar, Lëvizja e Legalitetit, Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptarë, Nisma Thurje, Bindja Demokratike, Partia Socialdemokrate dhe Balli Kombëtar u gjobitën me nga 500 mijë lekë, pasi “rezulton e provuar se kanë pasur mungesa në raportimin e kandidatëve të tyre, të cilat shkojnë sipas rastit, nga 1 deri në 153 kandidatë”.
- Muajt e marrë në analizë, përfshijnë edhe aksionet e fundit të SPAK për tragjedinë e 21 Janarit. Iniciativa është marrë nga Partia Socialiste pas një përgjimi të publikuar në media të cilat lidhin ish-komandantin e lartë të Gardës me dhënien e urdhrat për hapje zjarr ndaj protestuesve. SPAK ka marrë në pyetje disa figura të larta të politikës në vend, por opozita i ka cilësuar si lëvizje të cilat kanë për qëllim largimin e vëmendjes nga temat dhe problemet e ditës. Daljet publike dhe analizat mediatike për këtë proces duket se kanë një fund të njëjtë me ngjarjet e tjera të mëdha. Në mediat afër qeverisë tentohet ti hidhet faji qeverisë së atëhershme ndërsa në mediat kundër dhe të njëanshme analizohet audio përgjimi i gazetarit të kronikës në vend.